



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Nr. 506 Prot.

Tiranë, më 20.02.2024

**NJOFTIM PËR 1 (NJË) VEND TË LIRË PUNE NË QENDRËN E SHËRBIMIT TË
NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE LEZHË, DIBËR, ELBASAN, BERAT, KUKËS DHE
POGRADEC**

Në zbatim të ligjit Nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike garantuar nga shteti". Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë si dhe Mantëveshjes së Dakordësisë Në kuadër të Projektit "Zgjerimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri" me palë Ministrinë e Drejtësisë/ Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) me mbështetjen financiare të Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA) për periudhën 1 Mars 2024- 15 Tetor 2024, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas shpall procedurat e rekrutimit për vendet e lira si më poshtë vijon:

- Punonjës me trajnim të posaçëm, Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lezhë, Dibër, Elbasan, Berat, Kukës dhe Pogradec (1 pozicion për qendër)
- Kategoria e pagës: IV-II
- Vendndodhja:

Qendra	Vendndodhja
Lezhë	Bashkia Lezhë
Pogradec	Pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec
Dibër	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër
Elbasan	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan
Berat	Bashkia Berat
Kukës	Bashkia Kukës

- Lloji i punës: Punë me kohë të plotë.
- Në kuadër të Projektit "Zgjerimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri" me palë Ministrinë e Drejtësisë/ Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) me mbështetjen financiare të Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA)) për periudhën 1 Mars 2024-15 Tetor 2024.

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore

Qendra (Qendra e shërbimit të ndihmës juridike parësore) është një njësi e specializuar për dhënie të ndihmës juridike parësore, e organizuar si "njësi e drejtpërdrejtë e ofrimit të shërbimeve", sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, e cila ofron shërbime të ndihmës juridike falas duke garantuar akses të barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët.

- Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lezhë, Dibër, Elbasan, Berat, Kukës dhe Pogradec mbështeten nga UNDP në kuadër të marrëveshjes mbi zbatimin e projektit "Zgjerimi i

shërbimeve të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri” me palë Ministrinë e Drejtësisë/ Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) me mbështetje financiare të Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA).

- Referuar kësaj marrëveshje sigurohet ofrimi i pandërprerë i shërbimeve të ndihmës juridike falas në 6 qendrat të shërbimit të ndihmës juridike parësore për periudhën 1 Mars 2024-15 Tetor 2024, me mundësi zgjatje të kontratës deri në 31 Dhjetor 2024;
- Nga ana e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, me qëllim sigurimin e ofrimit të shërbimit në mënyrë të pandërprerë do të ndërmerren masa që në vitin 2025, të mundësohet kalimi me mbështetje financiare nga buxheti i shtetit të 6 qendrave të mbështetura nga UNDP.

Kërkesa të posaçme

Kualifikime: “*Punonjës me trajnim të posaçëm*” është punonjësi i diplomuar nga një program i ciklit të dytë të studimeve në drejtësi, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që i është nënshtruar një trajnimit të posaçëm, i cili ofron ndihmë juridike parësore në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore.

Eksperiencia: Jo më pak se 1 vit eksperiencë në punë si jurist/avokat

Detyrat kryesore

Punonjësi i qendrës jep ndihmën juridike parësore nëpërmjet:

1. Dhënies së informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor.
2. Dhënies së këshillimit mbi mënyrat dhe mundësitë e zgjidhjes së një çështjeje konkrete juridike.
3. Dhënies së këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve (ndërmjetësim, arbitrazh).
4. Dhënies së ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore;
5. Përfaqësimit përpara organeve administrative;
6. Dhënies në të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

Punonjësi, ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore, detyrohet:

- a) Të zisistojë çdo person që drejtohet pranë Qendrës me një kërkesë për ndihmë juridike.
- b) Të ndihmojë kërkuesin e ndihmës juridike që të plotësojë formularin për kërkimin e ndihmës juridike parësore; dytësore si dhe përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore;
- c) Të ofrojë shërbimin e ndihmës juridike me cilësi sipas standardeve të përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë me Udhëzimin e miratuar “*Për kriteret dhe metodologjinë e vlerësimit të cilësisë në ofrimin e ndihmës juridike*”;
- d) Të raportojë çdo muaj ose me kërkesë të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas lidhur me rastet dhe ecuritë e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike, duke i bashkëlidhur edhe dokumentacionin përkatës që provon kryerjen e shërbimeve të ofruara sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 1/2019, të Ministrit të Drejtësisë;
- e) Të bashkëpunojë me Drejtorinë së Ndihmës Juridike Falas për promovimin e sistemit të ndihmës juridike parësore përmes zhvillimit të aktiviteteve ndërgjegjësuese/edukimit ligjor të publikut;
- f) Të bashkëpunojë me ofruesit e tjerë të shërbimit të ndihmës juridike parësore në kuadër të

referimit të rasteve për ndihmë juridike;

- g) Të respektojë etikën dhe komunikimin me qytetarët që drejtohen pranë Qendrës;
- h) Të kryejë shërbimin e plotë të ndihmës juridike dhe të mos heqë dorë nga ofrimi i shërbimit përveç rasteve të konfliktit të interesit apo për shkaqe të tjera të arsyeshme. Nëse ka shkaqe për mosofrim ose ndërprerje të shërbimit, ai njofton menjëherë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, e cila merr masa për një ofertues alternativ për çdo rast.
- i) Të kryejë të gjitha detyrat e tjera të përcaktuara në ligj dhe aktet nënligjore në fuqi.

Aftësi të tjera

- Të ketë aftësi analitike;
- Të jetë i aftë të marrë vendime dhe të menaxhojë situata të paparashikuara;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe prezantuese.

Fusha e Njohurive mbi të cilat do të zhvillohet provimi me shkrim dhe intervista me gojë:

- Ligji nr 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe paketa e akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Familjes së Republikës së Shqipërisë;
- Ligj nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i përditësuar;
- Ligj nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Ligj nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligj nr. 10 221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” i përditësuar.

Provimi me shkrim dhe intervista me gojë do të konsistojnë në testimin e njohurive teorike dhe praktike duke patur në fokus kategoritë e veçanta përfituese të ligjit nr. 111/2017.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat (në format të njehsuar me origjinalin) si më poshtë:

1. Kërkesë për pozicionin;
2. Jetëshkrim i aplikantit (CV, sipas formatit të europass);
3. Diplomë (përfshirë edhe diplomën bachelor);
4. Librezë pune (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
5. Vërtetim për pagesën e kontributeve shoqërore/shëndetësore;

6. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj
(certifikata; trajnime; gjuhë e huaj; aftësi kompjuterike; artikuj shkencorë etj.)

Dokumentat duhet të dorëzohen **me postë** në Zyrat e Drejtorisë së Ndihmës Juridike
Falas brenda datës **28.02.2024**.

Mos përcjellja e dokumentacionit të kërkuar passjell skualifikimin.

Adresa: Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, Rruga "Jordan Misja", Njësia Bashkiake nr. 9, Godina
nr. 3, Tiranë

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ergys Qirici

